



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2024

VENDIM

Nr.336, datë 09.07.2024

PËR

**VERIFIKIMIN E PLOTËSIMIT NGA KANDIDATI Z. {...}
TË TRE KRITEREVE TË KANDIDIMIT PËR NGRITJEN NË DETYRË NË
GJYKATËN E APELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM PËR POZICIONIN
E LIRË NË FUSHËN E TË DREJTËS CIVILE, TË SHPALLUR ME VENDIMIN NR. 245
DHE NR. 246 DATË 02.05.2024, TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR DHE
VIJIMIN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT PËR KRITERET E TJERA LIGJORE
TË KANDIDIMIT**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 09.07.2024, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e tre prej kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm të kandidatin z. {...}”, përkatitur nga relatori z. Alban Toro, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...}, në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 245, dhe nr.246 datë 02.05.2024, të kritereve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale” dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit,

V Ë R E N

I. PROCEDURA E VERIFIKIMIT

1. Me Vendimin nr. 245, datë 02.05.2024 Këshilli i Lartë Gjyqësor (më poshtë referuar si Këshilli) ka vendosur:

1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile.

1.1 Me Vendimin nr. 246, datë 02.05.2024 Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur:

1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile.

2. Në këtë procedurë të ngritjes në detyrë për në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, afati i kandidimit është përcaktuar data 16.05.2024.

3. Brenda afatit të kandidimit ka kandiduar edhe z. {...} (më poshtë referuar si kandidati), gjyqtar i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, aktualisht gjyqtar i skemës së delegimit në Gjykatën Administrative të Apelit.

4. Me Vendimin nr. 266, datë 24.05.2024, “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 247, datë 02.05.2024; si edhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile të shpallura me vendimet nr. 244, nr. 245 dhe nr. 246 datë 02.05.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, Këshilli ka vendosur:

“1. Fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 247, datë 02.05.2024; si edhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile të shpallura me vendimet nr. 244, nr. 245 dhe nr. 246 datë 02.05.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Caktimin e relatorit si më poshtë: 11.Për kandidatin z. {...} - relator z. Alban Toro.

5. Më datë 27.05.2024, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” (më poshtë referuar si Vendimi 75/2019), në rrugë elektronike, kandidati u njoftua: - për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit; - për caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi; - për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtar tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi.

6. Brenda afatit të përcaktuar kandidati nuk parashtroi ndonjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj tij apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

7. Më datë 03.06.2024, bazuar në pikën 8, seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, në rrugë elektronike, kandidatit iu dërguan formularët dhe autorizimet përkatëse (të përcaktuara në pikën

6, seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019) që duhet të plotësoheshin dhe dorëzoheshin prej tij në kuadër të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit.

8. Brenda afatit pesëditor, kandidati depozitoi rregullisht dokumentacionin e kërkuar të kandidimit, pranë Zyrës së Protokollit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

9. Në vijim të procedurës së verifikimit, bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, përmes shkresave të veçanta, u kërkuar informacion dhe raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, për kandidatët e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, ndër ta edhe për kandidatin z. {...}. Për këto kriterë ligjore kandidimi procedurat e verifikimit janë në proces e sipër.

10. Sipas pikës 9, të Vendimit e Këshillit nr.245 dhe nr. 246 datë 02.05.2024 është përcaktuar se: *“Për kandidatin, për të cilin me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor verifikohet plotësimi i kriterëve ligjore të kandidimit sipas shkronjave “a”, “c” dhe “ç”, të pikës 5, të këtij vendimi, fillon menjëherë procesi i vlerësimit etik dhe profesional: ...”*. Ndërkohë, në pikën 5, shkronja “a”, të Vendimit e Këshillit nr.245 dhe nr. 246 datë 02.05.2024 përcaktohet se: *“Kriteret ligjore që duhet të plotësojë kandidati për t’u ngritur në detyrë pranë gjykatës së shkallës së dytë përcaktohen..., si më poshtë: a) Kandidati duhet të ketë ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet në shkallën e parë, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës civile, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar”*. Nga ana tjetër, në shkronjat “c” dhe “ç”, të pikës 5, të këtij vendimi, përcaktohet se: *“c) Kandidati duhet të mos ketë masë disiplinore në fuqi; ç) Kandidati duhet të mos jetë në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”*.

11. Në respektim të vendimit si më lart të Këshillit, sa i përket plotësimit të tre kriterëve formale të sipërpërmendura të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, me qëllim realizimin paralelisht edhe të procedurave të vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve, pra në funksion të përmbylljes sa më parë të procedurave të kandidimit, për kandidatin z. {...} u kërkuar dhe u administruar informacioni i nevojshëm nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, si organi kompetent për krijimin dhe administrimin e dosjeve personale dhe regjistrin të gjyqtarëve, si dhe nga gjykatat ku kandidati ka ushtruar funksionin e gjyqtarit.

11.1 Për verifikimin e kriterëve të “përvojës profesionale minimale” dhe atij të “mospasjes masë disiplinore në fuqi”, Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, përcolli informacionin dhe dokumentacionin përkatës të administruar për kandidatin z. {...}, siç do të përshkruhet më poshtë.

11.2 Sa i përket kriterit të “përvojës profesionale minimale” dhe pikërisht nënkriterit të “përvojës specifike profesionale” të kandidatit në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për

pozicionin e lirë ku ai ka kandiduar, pra në fushën e të drejtës civile, referuar gjykatave ku kandidati ka ushtruar funksionin e gjyqtarit, konkretisht në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, informacioni iu kërkuar të dyjave këtyre gjykatave informacioni i kërkuar është përcjellë në postën elektronike siç do të përshkruhet më poshtë.

12. Pas administrimit të dokumentacionit të nevojshëm, duke çmuar se procedura e verifikimit paraparak për kandidatin z. {...} në lidhje me tre kriteret formale të kandidimit të tij për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, ishte e plotë dhe në përputhje me kërkesat e Vendimit 75/2019, më datë 26.04.2024, relatori e parashtrroi çështjen përpara Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

13. Komisioni i Zhvillimit të Karrierës e shqyrtoi çështjen më datë 26.04.2024 dhe, pasi vlerësoi të plotë procedurën e verifikimit në këtë rast, bazuar në pikën 3, Seksioni C, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, vendosi kalimin e saj për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur ky i fundit për verifikimin paraparak dhe vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore e kandidatit {...} në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr.245 dhe nr. 246 datë 02.05.2024.

II. REZULTATET E VERIFIKIMIT PARAPRAK PËR TRE KRITERET E KANDIDIMIT

14. Për kandidatin z. {...} u verifikua kriteri i “përvojës profesionale minimale”.

15. “Përvoja profesionale minimale” për ngritjen në detyrë në gjykatën e shkallës së dytë në rastin konkret në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm , që gjen reflektim në shkronjën “a”, të pikës 5, të Vendimin e Këshillit nr.245 dhe nr. 246 datë 02.05.2024, është parashikuar si kusht kandidimi në nenin 47, pika 4, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“Magjistrati mund të ngrihet në detyrë në pozicione pranë gjykatave ose prokurorive të shkallës së dytë, nëse ka ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet në shkallën e parë, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e të drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar”.*

16. Për verifikimin e kandidatit në lidhje me plotësimin e këtij kriteri për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm u mbajt parasysh se ai ka kandiduar për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, çka do të thotë se kandidati, krahas përvojës së përgjithshme profesionale minimale, që është jo më pak se shtatë vjet, duhet të plotësojë edhe përvojën specifike profesionale minimale, pra jo më pak se pesë vjet në fushën e të drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionet e lira, konkretisht në fushën e të drejtës civile për pozicionet e lira të shpallur me Vendimin e Këshillit nr.245 dhe nr. 246 datë 02.05.2024.

17. Në lidhje me përvojën e përgjithshme profesionale, në kërkesat për shprehje interesi dhe në jetëshkrimin e dorëzuar nga kandidati, evidentohet se ai ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2007. Kandidati ka kryer stazhin profesional si gjyqtar në kuadër të vitit të tretë të Shkollës së Magjistraturës në vitet 2006-2007 pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Më pas, ai është emëruar përfundimisht gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec, ku ka ushtruar funksionin për periudhën 2007-2013. Nga data 04.11.2013, ai emërohet të ushtroj funksionin e gjyqtarit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Korçë si dhe delegohet për të kryer përkohësisht detyrën e Kryetarit të Gjykatës deri më datë 30.06.2022 si dhe në vijim ka ushtruar funksionin si gjyqtar pranë kësaj gjykate. Me vendet e Këshillit të Lartë Gjyqësor caktohet për të gjykuar si pjesë e skemës së delegimit pranë Gjykatës Administrative të Apelit, për periudhën 15.07.2022 e në vijim, ku dhe aktualisht ushtron funksionin.

18. Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, z. {...}, ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës në datë 05.07.2002 dhe Shkollën e Magjistraturës në vitin 2007. Me dekret nr. 5048, datë 04.10.2006 të Presidentit të Republikës emërohet gjyqtar dhe caktohet të kryejë stazhin profesional pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Me dekret nr. 5515, datë 14.11.2007 të Presidentit të Republikës caktohet gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec. Me dekret nr. 8267, datë 16.07.2013 të Presidentit të Republikës emërohet gjyqtar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë. Me vendim nr. 387, datë 28.10.2013 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë delegohet për të kryer përkohësisht detyrën e Kryetarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë. Me vendim nr. 41, datë 29.04.2015 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë emërohet Kryetar i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë. Me vendim nr. 243, datë 30.06.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor deklarohet përfundimi i funksionit si Kryetar i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë dhe në vijim ka ushtruar funksionin si gjyqtar pranë kësaj gjykate. Me vendim nr. 260, datë 15.07.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor caktohet për të gjykuar si pjesë e skemës së delegimit pranë Gjykatës Administrative të Apelit, për një periudhë 1 (një) vjeçare. Me vendim nr. 365, datë 13.07.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor ri caktohet për të gjykuar si pjesë e skemës së delegimit pranë Gjykatës Administrative të Apelit, për një periudhë 3 (tre) vjeçare, ku dhe aktualisht ushtron funksionin. Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 17 vite. Z.{...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

19. Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se kandidati z. {...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr.245 dhe nr. 246 datë 02.05.2024, ka mbi shtatë vjet përvojë të përgjithshme profesionale si gjyqtar i gjykatës së shkallës së parë dhe shkallës së dytë, duke plotësuar kështu kriterin “përvojës profesionale minimale”.

20. Sipas informacionit të përcjell nga Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, rezulton se:

“... z. {...}, fillimin në detyrë e ka me Dekretin nr. 5048, datë 04.10.2006, ku është emëruar për të kryer stazhin profesional pranë kësaj gjykate dhe më pas me Dekretin nr. 5515, datë 14.11.2007 të Presidentit të Republikës, është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Pogradec, si dhe në vitin 2013 është emëruar gjyqtar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Korçë. Në lidhje me sa kërkoni, për periudhën kohore për të cilën kërkohet informacioni për përvojën e gjyqtarit z. {...}, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, nuk disponon urdhra të Kryetarit për ndarjen në dhoma/seksione të gjyqtarëve. Në mungesë të tyre, bashkëngjitur kësaj shkrese, gjeni në format statistikor, llojet e vendimeve gjyqësore të dhëna nga gjyqtar z. {...}, për periudhën 2006-2007...”.

Referuar të dhënave të regjistrit të vendimeve civile për vitin 2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kandidati z. {...}, referuar objektit të çështjeve gjyqësore, është shortuar dhe ka gjykuar 2 çështje në lëndë administrative nga 25 çështje në total me natyrë civile.

21. Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjell nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, rezulton se “...Gjyqtari {...}, me Dekretin nr. 5515, datë 14.11.2007 të Presidentit të Republikës është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec nga data 14.11.2007 dhe është transferuar në datë 31.10.2013. Për vitin 2007 nuk është gjetur ndonjë urdhër i Kryetarit të Gjykatës për ndarjen e gjyqtarëve sipas llojit të çështjeve por është shkresa e KLD “Për caktim gjyqtari në gjykata të rretheve gjyqësore”. Për këtë periudhë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec nuk ka funksionuar e ndarë në seksione (seksion civil/ seksion penal/ seksion administrativ), por ka funksionuar me trupa gjykues për gjykimin e çështjeve civile/ penale... Gjykata ka gjykuar çështje civile-administrative (mikse), ndërsa çështjet e mirëfillta administrative janë dërguar për kompetencë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë. Nga verifikimi i kryer në arkivën e gjykatës, rezulton se z. {...} gjatë kësaj periudhe ka gjykuar të gjitha llojet e çështjeve...”.

21.1 Ndërkohë referuar të dhënave, rezulton se kandidati z. {...}, nga data 16.07.2013 dhe në vijim, është gjyqtar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë e më pas Gjykata e Apelit Administrativ e për rrjedhojë që nga kjo datë ai ka gjykuar vetëm çështje me lëndë administrative.

22. Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se kandidati z. {...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr.245 dhe nr. 246 datë 02.05.2024, ka mbi pesë vjet përvojë profesionale në fushën e të drejtës civile, duke plotësuar kështu kriterin e “përvojës specifike profesionale minimale”.

23. Për kandidatin z. {...} u verifikua edhe kriteri i “mospasjes masë disiplinore në fuqi”.

24. “Mospasja masë disiplinore në fuqi” si kriter për ngritjen në detyrë edhe në gjykatën e shkallës së dytë, që gjen reflektim në shkronjën “c”, të pikës 5, në Vendimin e Këshillit nr.245 dhe nr.246 datë 02.05.2024, është parashikuar në nenin 48, pika 8, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“Vetëm kandidatët të cilët ... nuk kanë masa disiplinore në fuqi, pranohen në procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë”*.

25. Në lidhje me këtë kriter, në rastin e aplikimit, kandidati ka depozituar formularin e Vetëdeklarimit “Për masa disiplinore” datë 08.05.2024, nëpërmjet të cilës, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: *“Nuk kam masë disiplinore në fuqi”*.

26. Sipas informacionit të përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidati z. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

27. Sa sipër, Këshilli vlerëson se nuk vërtetohet se për kandidatin z. {...} të ketë masë disiplinore në fuqi, duke plotësuar kështu kriterin e “mospasjes masë disiplinore në fuqi”.

28. Për kandidatin z. {...} u verifikua edhe kriteri i “papajtueshmërisë ambientale”.

29. Papajtueshmëria ambientale si kriter ndalues për ngritjen në detyrë edhe në gjykatën e shkallës së dytë, që gjen reflektim në shkronjën “ç”, të pikës 5, në Vendimin e Këshillit nr.245 dhe nr. 246 datë 02.05.2024, është parashikuar në nenin 8, pika 2, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“Këshillat, gjatë ... ngritjes në detyrë të magjistratit, për aq sa është e mundur dhe pa cenuar në mënyrë joproporcionale të drejtën për zhvillimin normal të karrierës profesionale të magjistratit, marrin masa për të shmangur papajtueshmërinë ambientale, sipas pikës 3, të këtij neni, me qëllim që të garantohet besimi i publikut në sistemin e drejtësisë, pavarësia dhe paanësia e magjistratit, eficienta e gjykatave dhe zyrave të prokurorisë në dhënien e drejtësisë”*. Ndërkohë, kuptimi i papajtueshmërisë ambientale përcaktohet në pikën 1, të kësaj dispozite ligjore, sipas të cilës: *“Papajtueshmëria ambientale, në kuptimin e këtij neni, krijohet për shkak të lidhjeve të ngushta familjare mes magjistratëve, që janë përkatësisht bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë”*. Sa i takon rasteve të papajtueshmërisë ambientale për sa lidhet me ngritjen në detyrë në gjykatën e shkallës së dytë, ato parashikohen në pikën 3, shkronja “a”, të kësaj dispozite ligjore, ku përcaktohet se: *“Papajtueshmëri ambientale përbëjnë rrethanat e mëposhtme: a) nëse respektivisht në të njëjtën gjykatë ose prokurori ku magjistrati kërkon të caktohet, ushtron funksionin një magjistrat tjetër, që ndodhet në kushtet e pikës 1 të këtij neni”*.

30. Në lidhje me papajtueshmërinë ambientale, në rastin e aplikimit, në përputhje me detyrimin sipas nenit 8, pika 5, të Ligjit për Statusin, kandidati ka depozituar formularin e Vetëdeklarimit “Për situatën e papajtueshmërisë ambientale” datë 08.05.2024, nëpërmjet të cilës, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: *“Nuk do të ndodhem në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”*.

31. Gjatë verifikimit nuk rezultoi ndonjë e dhënë e ndryshme nga ajo e deklaruar nga kandidati në lidhje me situatën e papajtueshmërisë ambientale për sa ai kandidon për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm

32. Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se për kandidatin z. {...} nuk vërtetohet të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale në rast të ngritjes në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, duke plotësuar kështu kriterin e “papajtueshmërisë ambientale”.

III. KONKLUZIONE

33. Referuar kërkesave të Vendimit 75/2019, duke mbajtur parasysh edhe përcaktimet e Vendimit të Këshillit nr.245 dhe nr. 246 datë 02.05.2024, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së verifikimit paraprak të tre kriterëve formale të kandidimit të z. {...}, për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës civile, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se procedura e verifikimit e ndjekur në këtë rast është e plotë dhe në përputhje me ligjin.

34. Bazuar në sa më lart është parashtruar mbi rezultatet e verifikimit paraprak të tre kriterëve formale të kandidimit për kandidatin z. {...}, konkretisht të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se kandidati i plotëson ato, ndërsa nuk ekziston ndonjë shkak për s’kualifikimin nga kandidimi në lidhje me këto kriterë. Nisur nga kjo, Këshilli çmon se është vendi për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, të tre kriterëve të sipërpërmendura të kandidimit dhe vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatës për kriteret e tjera ligjore në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr.245 dhe nr. 246 datë 02.05.2024.

PËR KËTO ARSYE

Mbështetur në pikën 3, të nenit 136, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 8, në pikën 5, të nenit 47, në pikën 8, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, si dhe në pikën 9, të Vendimit të tij nr. 245, datë 02.05.2024, “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në fushën e

të drejtës civile”; Vendimit nr. 246, datë 02.05.2024, “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në fushën e të drejtës civile”, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

V E N D O S I :

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...}, në procedurat e ngritjes në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr.245 dhe nr. 246 datë 02.05.2024, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.
2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr.245 dhe nr. 246 datë 02.05.2024.
3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR